



**QASEMI**

**SI T'I  
GJYKATËS?**

**Gjykata Themelore e Prizrenit**

**[www.kgjk-ks.org](http://www.kgjk-ks.org)**



**USAID**  
NGA POPULLI AMERIKAN  
OD AMERICKOG NARODA



*Ky dokument është hartuar nga EC Ma Ndryshe për Gjykatën Themelore të Prizrenit, në kuadër të projektit Lidhja e komunitetit me shërbyesit e drejtësisë, që përkrahet financiarisht nga USAID dhe mbikqyret nga ATRC.*

*"Ky dokument u mundësua me përkrahjen bujare të popullit amerikan përmes Agjencisë së Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID). Përmbajtja është përgjegjësi e EC Ma Ndryshe dhe nuk pasqyron doemos pikëpamjet e USAID-it apo të Qeverisë së Shteteve të Bashkuara".*

## **GJYKATA THEMELORE E PRIZRENIT**

### *Gjykatë e Hapur*

Gjykata Themelore është gjykata e parë ku ju i filloni procedurat tuaja gjyqësore. Gjykata Themelore e Prizrenit ka jurisdiksion të përgjithshëm, që do të thotë se ajo i gjykon të gjitha çështjet në shkallë të parë përpos nëse me ligj parashihet ndryshe.

## **C**

### **ilat janë departamentet e Gjykatës Themelore në Prizren?**

Gjykata Themelore në Prizren ka tri departamente dhe një divizion:

- Departamenti i Përgjithshëm, i cili merret me shumicën e lëndëve penale dhe civile dhe me rastet e kundërvajtjeve,
- Departamenti për të Mitur, i cili merret me lëndët në të cilat janë të përfshirë kryerësit e mitur,
- Departamenti për Krime të Rënda, i cili merret me lëndë që ceken në Nenin 15 të Ligjit për Gjykata dhe në Nenin 22 të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës, dhe
- Divizioni i Kundërvajtjes.

## **K**

### **u gjenden degët e gjykatës?**

Kjo gjykatë ka selinë qendrore në Prizren, ndërsa degët e saj në Suharekë dhe Dragash, të cilat i shqyrtojnë rastet që bëjnë pjesë vetëm brenda kompetencave të departamentit të përgjithshëm.

## **C**

### **ilat janë pesë zyrat e gjykatës?**

Shërbimet administrative dhe mbështetëse të gjykatave janë riorganizuar në pesë zyra:

1. Zyra qendrore për menaxhimin e lëndëve,
2. Zyra për mbështetje juridike,
3. Zyra e financave,
4. Zyra për sigurim dhe logjistikë, dhe
5. Zyra për informim publik.

## **C**ila është detyra e ZQML-së?

Zyra qendrore për menaxhimin e lëndëve është përgjegjëse për lëvizjen e lëndëve brenda gjykatës, prej pranimit deri në marrje të vendimit. Stafi i ZQML-së kujdeset që faktorët brenda dhe jashtë kontrollit të gjykatës të mos ndikojnë në krijimin e vonesave në procedimin e lëndëve. Lëndët që pranohen nga ZQML-ja i drejtohen për shqyrtim departamenteve të specializuara që funksionojnë brenda Gjykatës Themelore në Prizren.

## **S**i bëhet dorëzimi i shkresave?

Qytetarët kanë ne dispozicion disa mundësi që t'i dorëzojnë gjykatës shkresat e tyre. Shkresat mund ti dorëzohen gjykatës:

- Personalisht;
- Përmes shërbimit postar;
- Çfarëdo mjeti tjetër të dorëzimit të shkresave.

Të gjitha shkresat e dërguara gjykatës përmes postës apo personalisht i dorëzohen referentit të pranimit. Shkresat e pranuar vulojnë nga referenti i pranimit, pa i hapur ato. Për të gjitha parashtresat gjyqësore për të cilat kërkohet pagesa e taksës gjyqësore, zbatohet udhëzimi administrativ mbi unifikimin e taksave gjyqësore.

## **S**i caktohen dhe ndahen lëndët?

Shpërndarja e lëndëve tek gjyqtarët bëhet me short. Të gjitha lëndët e pranuar ndahet në grumbuj sipas numrit të gjyqtarëve dhe llojit të lëmisë juridike gjyqësore. Mbi çdo grumbull të lëndëve vihet një procesverbal në të cilin përshkruhet numri dhe lloji i lëndëve të cilat do të tërhiqen nga gjyqtari të cilit i bie shorti.



## **K**ur kalon lënda te gjyqtari?

Ditën e regjistrimit, lënda i dërgohet gjyqtarit për shqyrtim. Shqyrtimi i lëndës nga gjyqtari shërben për t'iu shmangur vonesave në situatat e jo kompetencës së gjykatës. Ditën kur gjyqtari e kthen lëndën në ZQML, referenti e shqyrton vendimin e gjyqtarit dhe merr të gjitha veprimet e nevojshme. Lënda i kalohet prape gjyqtarit një ditë para seancës apo edhe më herët sipas kërkesës së gjyqtarit. Ndërsa, përjashtimi i gjyqtarit nga rasti bëhet me kërkesën e palës apo të gjyqtarit kur ekzistojnë arsyet ligjore, apo ka konflikt interesi, dhe për këtë vendos Kryetari i Gjykatës.

## **S**i bëhet përgatitja për seancë?

ZQML është përgjegjëse për të gjitha hapat përgatitore tekniko-administrativ për të siguruar mbarëvajtjen e seancës. Duke pas parasysh afatet procedurale, referenti do të bashkërendojë me sekretaret juridike dhe dorëzuesit e gjykatës përpilimin dhe dorëzimin e thirrjeve (ftesave) për të gjithë palët, sigurimin se dëshmitarët dhe ekspertet janë ftuar me rregull, thirrjen e gjyqtarëve porotë nëse ka nevojë, verifikimin se lënda është kompletuar dhe janë plotësuar kushtet për mbajtjen e seancës.

Lëndët shpesh ndërpriten përkohësisht, sepse veprimi duhet të ndërmerret nga një institucion i jashtëm. Rastet më të shpeshta janë:

- Kërkesë drejtuar regjistrimit civil për një adresë,
- Kërkesë drejtuar policisë për një adresë;
- Njoftimi i dërguar përmes shërbimit postar;
- Njoftimi jashtë vendit i dërguar përmes kanaleve përkatëse apo Ministrisë së Drejtësisë së Kosovës,
- Urdhër-arrest i dërguar policisë.

## **A** mund të merrni pjesë në seanca?

Te gjitha seancat gjyqësore janë të hapura për publikun, përveç në rastet e përcaktuara me ligj. Për të marrë pjesë mund të shihni:

- Tabelën e njoftimeve,
- Monitorin,
- Faqen e internetit, ose
- Kontaktoni zyrtarin për informim publik.

Një mundësi tjetër për t'u njohur me punën e gjykatës janë edhe "Ditët e Hapura" kur qytetarët mund të takojnë kryetarin e Gjykatës çdo dy javë, të hënën e parë dhe të tretë të çdo muaji.

## **S** i kryhet arkivimi i lëndëve?

Arkivimi nënkupton ndarjen e lëndëve si më poshtë:

- Lëndë që do të mbeten në gjykatë,
- Lëndë që do t'i transferohen Arkivit të Qytetit/Shtetit për ruajtje të mëtejme, dhe
- Lëndë që do të asgjësohen.

## **K**ontaktoni Gjykatën Themelore në Prizren

Zyra e Administratës  
Tel: +381 (0) 29/244 122

Adresa  
Gjykata Themelore e Prizrenit  
Rr. "Ibrahim Lutfiu", p.n.  
Prizren, Kosovë

Vizito [www.kgjk-ks.org](http://www.kgjk-ks.org)

